



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 4 shkurt 2022
Nr.ref.:RK 1935/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI208/21

Parashtrues

Ramadan Dibrani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Rev. nr. 92/2020, të 7 majit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ramadan Dibrani, me banim në Podujevë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 92/2020] e Gjykatës Supreme të Kosovës, të 7 majit 2021.
3. Parashtruesi i kërkesës, Aktgjykimin e lartpërmendur e ka pranuar më 29 qershor 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, përmes së cilit parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 19 nëntor 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 22 nëntor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 23 nëntor 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës e dërgoi në Gjykatën Supreme.
9. Më 8 dhjetor 2021, Gjykata e njoftoi edhe Gjykatën Themelore në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
10. Më 15 dhjetor 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë e dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
11. Më 20 janar 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga shkresat e rastit rezulton se parashtruesi i kërkesës është i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KEK), në pozitën Udhëheqës i Sektorit të Sigurisë Industriale, ku më 17 korrik 2007, pas miratimit të Skemës Organizative të KEK-ut, Drejtori Ekzekutiv i Departamentit të Shpërndarjes kishte emëruar parashtruesin e kërkesës në pozitën Menaxher i Departamentit të Sigurisë në Punë, Sigurisë Industriale si dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Më tutje, rezulton se parashtruesi i kërkesës nuk ishte kompensuar nga KEK-u e për diferencën e pagës ndërmjet dy pozitave të lartpërmendura.
13. Më 14 tetor 2009, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, kundër KEK-ut, ku kishte kërkuar kompensimin e diferencës së pagave për periudhën kontestuese nga 17 korriku 2007, duke kërkuar edhe kamatën ligjore.
14. Më 23 shkurt 2016, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 2320/09] aprovoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke e obliguar KEK-un që bazuar në ekspertizën financiare të kompensojë parashtruesin e kërkesës në shumën prej 24.676.00 euro, për periudhën kontestuese nga 17 korriku 2007 deri më 25 tetor 2015, me kamatën ligjore siç e paguajnë bankat për mjetet pa destinim të caktuar, si dhe shpenzimet administrative.
15. Në një datë të paspecifikuar, KEK-u kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 28 maj 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 2453/16] aprovoi si të themeltë ankesën e KEK-ut dhe ndryshoi Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjykata e Apelit refuzoi, tërësisht, si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës. Gjykata e Apelit në arsyetim të Aktgjykimit të saj kishte theksuar se gjykata e shkallës së parë në këtë rast kishte zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale, por gjendja faktike nuk korrespondon drejtë me provat e prezentuara.
17. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
18. Më 7 maj 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 92/2020] refuzoi si të pabazuar revizionin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, duke konsideruar se aktgjykimi i shkallës së dytë është i drejtë dhe i ligjshëm.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon që me Aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
20. Parashtruesi i kërkesës së pari pretendon se Aktgjykimi i kontestuar, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit: *“kanë zbatuar dispozitat e nenit 10, 11 dhe 17 të Ligjit të Punës i cili nuk ka qenë në fuqi në kohën kur ka lindur kontesti, dhe zbatimi i dispozitave të cekura është në kundërshtim direkt me dispozitat e nenit 96 të Ligjit të Punës”*.
21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta, duke zbatuar dispozitat ligjore të cilat nuk janë në fuqi kanë shkelur parimet kushtetuese se: *“çështja konkrete juridike zgjidhet sipas dispozitave ligjore në fuqi”*.
22. Parashtruesi i kërkesës më tutje shton se në rastin konkret kemi të bëjmë me dy qëndrime juridike të gjykatës së shkallës së parë dhe të dy gjykatave të instancave më të larta, të cilat janë diametralisht të kundërta.
23. Parashtruesi i kërkesës në fund pretendon se vendimi i kontestuar *“e ka shkelur parimin e mbrojtjes së pronës i sanksionuar me dispozitën e nenit 46 të Kushtetutës, lidhur me dispozitën e nenit 24, paragrafi 2 pasi ndaj parashtruesit të kërkesës është vepruar mbi bazën e diskriminimit, pasi te i njëjti punëdhënës është kompensuar me pagë më të ulët se kolegët e tij për kryerjen e punëve identike, me kualifikim të njëjtë dhe me përvojë pune të njëjtë”*.
24. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesa të shpallet e pranueshme dhe të shpallë të pavlefshëm vendimin e kontestuar.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

26. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 i Ligjit
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48 i Ligjit
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49 i Ligjit
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]".

27. Në fillim, Gjykata i referohet datës së dorëzimit të vendimit përfundimtar dhe datës së parashtrimit të kërkesës në Gjykatë për të vlerësuar nëse parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të caktuar prej 4 (katër) muajve.
28. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që vendimi i fundit në rastin e parashtruesit të kërkesës është Aktgjykimi [Rev. nr. 92/2020] i Gjykatës Supreme të Kosovës, i 7 majit 2021.
29. Në bazë të fletëkthesës, të cilën Gjykata Themelore në Prishtinë në përgjigjen e saj të 15 dhjetorit 2021, e ka dorëzuar në Gjykatë, kjo e fundit vëren se parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 29 qershor 2021.
30. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 29 qershor 2021, ndërsa kërkesën në Gjykatë e ka dorëzuar më 19 nëntor 2021, që do të thotë se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar ligjor.
31. Gjykata përsërit se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që ngrenë çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe për të parandaluar autoritetet dhe palët e tjera të interesuara që të mbahen në gjendje të pasigurisë për një periudhë më

të gjatë kohore (shih, Vendimin e GJEDNJ-së, *Olivier Gaillard kundër Francës*, nr. 47337/99, të 11 korrikut 2000, shih, Vendimin e GJEDNJ-së *Franz Hofstädter kundër Austrisë* nr. 25407/94, 12 shtator 2000).

32. Ky afat gjithashtu i mundëson parashtruesit potencial të kërkesës që të shqyrtojë nëse dëshiron të paraqesë kërkesë dhe, nëse dëshiron, të vendosë për ankesat dhe argumentet konkrete që duhet ngritur (shih, Vendimin e GJEDNJ-së *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, parashtresa nr. 23274/04), dhe të njëjtën kohë lehtëson vërtetimin e fakteve në këtë rast, meqë me kalimin e kohës, çdo shqyrtim i drejtë i çështjeve të ngritura bëhet problematik.
33. Ky rregull specifikon afatin kohor për kontrollin e ushtruar nga Gjykata dhe paralajmëron individët dhe autoritetet shtetërore për afatin pas të cilit kontrolli i tillë nuk është më i mundur (shih, Vendimin e GJEDNJ-së, *Walker kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 34979/97, e 25 janarit 2000, shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Sabri Güneş kundër Turqisë*, e 29 qershorit 2012, paragrafi 40).
34. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme, sepse kërkesa e parashtruesit të kërkesës është parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113. 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 20 janar 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Ertesa Caka-Nimani